



KOMPANIA REGJIONALE PËR MBETURINA
REGIONALNA KOMPANIJA ZA OTPADKE
"EKOREGJIONI" SH. A. –D.D. PRIZREN

Email:krm_ecoregjioni@yahoo.com

Prizren, 20.02.2018

Kompania Regjionale për Mbeturina "Ekoregjioni" SH.A. me seli në Prizren, respektivisht Kryeshefi Ekzekutiv, në bazë të nevojës së paraqitur në Njesine Operative Rahovec, dhe Njesine Operative Prizren ne sektorin e inkasimit dhe operatives në përputhje me Ligjin e Punës, Statutin e Kompanisë dhe Rregulloren e Mbrendshme , konform vendimeve të Kryeshefit Ekzekutiv te dates 13.02.2018-nr.01-02/410,dt.09.02.2018-nr.01-04/360 dhe te dt.13.02.2018 –nr.01-04/411 shpall këtë:

K O N K U R S

Për vend te lirë pune 6

Në Njësinë Operative Rahovec

Vendi i punës Rahovec,
Vende të lira 4.

Titulli i vendit te punes:

- *Inkasant, 2*
- *Punetor fizik, 2*

Në Njësinë Operative Prizren

Vendi i punës Prizren,
Vende të lira 2.

- *Titulli i vendit te punes: Punetor fizik, 2*

Detyrat e dhëna të punësuarit- përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës pozita inkasant përmban si vijon:

- bën inkasimin e mjeteve në bazë të faturave me të cilat ngarkohet materijalisht,
- bën zbulimin- regjistrimin me kohë të sipërfaqeve të reja dhe të paregjistruara
- përcjell ndryshimet apo ndërrimet e sipërfaqeve dhe ndryshimet tjera të nevojshme në sektorin e amvisëris respektivisht komercial duke e nojftuar Shërbimin e faturimit.
- të gjitha paratë e inkasuara i dorëzon brenda dite, në bankën më të afërt apo sipas nevojës në arkën kryesore të kompanisë,

- kryen edhe punë të tjera të përcaktuara nga punëdhënësi sipas nevojës të procesit të punës në interes të ndërmarrjes.

Raporton te faturisti,financieri dhe menaxheri I njesise.

Nen pergjegjesin e : pergjegjesit te inkasanteve, pergjegjesit financiare / Menaxherit te Njesise Operative/

Detyrat e dhëna të punësuarit- përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës pozita puntor fizik përmban si vijon:

Kryen të gjitha punët fizike ne mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave, zbrazen e kontejnerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre.Sipas planit operativ dhe urëdhnesës se punës bën fshirjen-pastrimin dhe larjen e rrugëve, apo pastrimin e rrugës dhe trotuarve nga bora dhe akulli, hudhjen e kripës.Bën largimin e qenëve dhe macave të ngordhura dhe vendosjen e tyre në kontejner.Është i obliguar që të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytzusve të sherbimeve. Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të kontejnerëve dhe mjeteve të punës,

- I Punësuarit i raporton udhëheqësit të vet: **Kryepunëtorit & gjegjësisht menaxhmentit në operativës.**

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Kopja e letërnjoftimit,
- Kopja e certifikates se lindjes,
- Certifikatën shëndetësore,
- Certifikata për të kaluarën kriminale, nga Gjykata Themelore dhe nga Policia e Kosoves.
- Kopje e diplomes ose certifikatat e shkolles mesme ose me superiore.
- Kerkesa me numër të telefonit bashke me deshmi tjera qe tregojne per përvojë pune.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes.

Dokumentacioni jo i plotë nuk do të merret në konsideratë.

Kandidatët të cilët I plotësojn kriteret, do të njoftohen me telefon për vendin dhe kohën e intervistës.

Dokumentacioni I kërkuar bashke me kerkesen(aplikacionin) plotesohet dhe dorezohet në zyret e Ekoregjionit, adresën KRM “Ekoregjioni” SH.A. Rr. Kukësit nr. 10 në Prizren- Per aplikuesit ne Njesine e Rahovecit dorezohen ne Rahovec, ndersa aplikuesit per Njesine e Prizrenit ne Njesine Operative Prizren, **kopjet e dorzuara nuk kthehen.**